



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 156/2 prot.

Tiranë, më 10.02.2022

V E N D I M

Nr. 37 , datë 10 . 02 . 2022

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, është paraqitur ankesa nr. 27 Regj., datë 02.02.2022, e shtetasit B. M, kundër Këshillit të Lartë të Prokurorisë², me pretendim diskriminim për “çdo shkak tjetër”³.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se ka ushtruar funksionin e Prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, deri në datën 31.03.2021.

Me Vendimin nr. 1752, datë 16.07.2020, Inspektorati i Lartë të Drejtësisë ka iniciuar kryesisht hetimin disiplinor ndaj B. M, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

¹ Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

² Në vijim referuar me akronimin KLP.

³ Ankuesi ka shënuar “çdo shkak tjetër” tek lista me shkaqet e pretenduara të diskriminimit, në formularin e ankesës pranë KMD-së, pa dhënë shpjegime, prova e fakte se çfarë karakteristike identifikuese, personale posedon ai, e cila të ketë shërbyer edhe si shkak për trajtimin e tij të pabarabartë e të pafavorshëm nga ana e KLP-së.

Me datë 16.01.2021 subjekti ankues është njohur me Raportin nr. 1752/21 prot., datë 14.01.2021, të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, për përfundimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj z. M dhe me fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit B. M si dhe me propozimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për masën disiplinore “Shkarkim nga detyra”.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se në përfundim të procedurës disiplinore, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ka disponuar me Vendimin nr. 81, datë 31.03.2021, si më poshtë citohet:

- *“Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nr. 104 prot., datë 15.01.2021 “Për procedimin disiplinor ndaj magjistratit B. M”.*
- *Shkarkimin nga detyra të magjistratit B. M, me detyrë Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.*
- *Vendimi i arsyetuar me shkrim, i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe B. M, brenda 5 ditëve nga data e shpalljes.*
- *Të njoftohet Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij Vendimi.*
- *Kundër këtij Vendimi lejohet ankimim sipas ligjit, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.*
- *Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.*

Me datë 19.04.2021, subjekti ankues ka ankimuar vendimin sipërcituar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si KPA). Rezulton se, bazuar në rrethanat e faktit, me datë 11.06.2021, KPA ka disponuar me vendimin për kalimin e ankimit të B. M në seancë gjyqësore publike, dhe aktualisht çështja është në fazën e gjykimit pranë këtij Kolegji.

Subjekti ankues, ka parashtruar në ankesën e tij se: *“Ligjvënësi ka sanksionuar se në rastet e procedimeve disiplinore, kur Këshillat publikojnë vendimet për këto procedime disiplinore, duhet të ruhet konfidencialiteti duke mbajtur anonimizimin e identitetit të magjistratëve, subjekte të procedimeve disiplinore.*

Në rrethanat e faktit rezulton se, pala diskriminuese, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), në kundërshtim me detyrimet ligjore të sanksionuara në ligjin e posaçëm për statusin, për të ruajtur konfidencialitetin e të dhënave të magjistratit, në rastin konkret të ankuesit, ka publikuar si në faqen zyrtare të Kolegjit, ashtu dhe në ekstraktin e vendimit të arsyetuar gjeneralitetet e plota të magjistratit, identitetin e tij.

Nga rrethanat e faktit rezulton se, për magjistratë të tjerë që kanë pasur të njëjtën pozitë procedurale sikurse ankuesi, KLP, ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga ai për ankuesin B. M, duke provuar qartësisht se mungesa e disponimit nga ana e KLP-së, për ankuesin është rast unikal në praktikat e Këshillit.

Konkretisht, në rastin e fundit të trajtimit të një procedimi disiplinor, konkretisht për magistratin.....prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, rezulton se autoriteti diskriminues ka disponuar me trajtimin e përkohshëm të tij deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata më e lartë”.

Nga aktet e disponuara në dosjen e ankuesit, rezulton se, B. M ka ngritur gjyqësisht pretendimin e tij kundrejt KLP-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka disponuar me vendimin e datës 17.01.2022, ndër të tjera, si më poshtë citohet:

“...Detyrimin e palës së paditur, Këshilli i Lartë i Prokurorisë që të përcaktojë trajtimin financiar dhe përfitimet e tjera për magistratin B. M, sipas përcaktimit të nenit 157, të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, derisa vendimi nr. 81, datë 31.03.2021 “Për caktimin e masës disiplinore shkarkim nga detyra” të marrë formë të prerë.

...Ky vendim është titull ekzekutiv në zbatim të nenit 510/a, të K.Pr.Civile, dhe është drejtëpërdrejtë i ekzekutueshëm nga Shërbimi Përmbartimor shtetëror/privat, nga data e shpalljes së këtij vendimi”.

Vendimi gjyqësor nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, është dhënë me ekzekutim të përkohshëm, por rezulton se deri në këto momente KLP, nuk ka ndërmarrë ndonjë hap për përmbushjen e këtij detyrimi gjyqësor.

Gjithashtu, ankuesi ka pretenduar se, edhe përsa i përket pretendimit të tij për diskriminim në përhapjen e identitetit të tij, duke cënuar të drejtat e tij kushtetuese për t’u konsideruar i pafajshëm deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë nga gjykata më e lartë, qëndrimi i KLP-së është sërish unikal për ankuesin, pasi në raste të ngjashme sikurse në rastin e magistrates....., prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, autoriteti diskriminues ka përmbushur detyrimin ligjor të anonimizimit të identitetit të saj, si përsa i përket ekstraktit të shpallur në faqen e KLP-së, ashtu dhe në materialin audio të datës 10.01.2022, kur është realizuar seanca plenare për procedimin disiplinor në ngarkim të saj.

Në përfundim, ankuesi ka pretenduar se KLP e ka vënë atë në pozitë të pabarabartë në raport me subjekte të tjera që kanë qenë në pozitë të njëjtë (me ankuesin), duke theksuar se, ankuesi dhe subjektet e tjera të referuara prej tij, gëzojnë të njëjtën cilësi sikurse ai (magjistratë dhe prokurorë) dhe janë subjekte të procedimeve disiplinore po ashtu si ai.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si më poshtë citohet:

- *“Konstatimin e vendimit nr. 81, datë 31.03.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si një vendim që diskriminon të drejtat kushtetuese të ankuesit B. M.*
- *Detyrimin e KLP, të dalë me vendim për trajtimin e përkohshëm financiar të magjistratit B. M, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.*
- *Detyrimin e KLP, që të anonimizojë të dhënat e ankuesit në përputhje me detyrimin ligjor të parashikuar nga ligji i posaçëm, në të gjitha materialet e publikuara në faqen zyrtare të KLP, përfshirë vendimin nr. 81, datë 31.03.2021 dhe materialet audio të datës 16.03.2021, dhe të datës 01.04.2021, ku jepen publikisht të dhënat për ankuesin B. M”.*

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të

shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:

- A. Lidhur me kërkimin e ankuesit për konstatimin e vendimit nr. 81, datë 31.03.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si një vendim që diskriminon të drejtat kushtetuese të tij, dhe detyrimin e KLP, të dalë me vendim për trajtimin e përkohshëm financiar të tij.

Subjekti ankues, ka ngritur pretendime ndaj Këshillit të Lartë të Prokurorisë, lidhur me vendimmarrjen e datës 31.03.2021, (nëpërmjet vendimit sipërcituar), si një vendim që cënon të drejtat e tij kushtetuese. Ai ka kërkuar konstatimin e vendimit të KLP si diskriminues.

Komisioneri vëren se, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si një prej organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ushtron veprimtarinë e tij, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, të ndryshuar, i cili në nenin 190⁴, të tij, ndër të tjera, parashikon se:

“ Aktet administrative individuale të Këshillit, në lidhje me statusin e prokurorëve ose nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë, bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, të shoqëruara me arsyetimin përkatës, pasi të redaktohen për sigurimin e anonimatit të subjekteve, përveç rasteve të parashikuara ndryshe në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Njoftimi i akteve administrative kolektive, në lidhje me statusin e të gjithë prokurorëve ose nëpunësve civilë, bëhet nëpërmjet botimit në faqen zyrtare të Këshillit. Këto akte hyjnë në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit.

Ky nen zbatohet edhe për aktet e nxjerra nga komisionet e Këshillit”.

Ky ligj, në nenin vijues, nenin 192⁵, të tij, lidhur me të drejtën e ankimit kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ka parashikuar se:

“ Ndaj aktit administrativ individual të Këshillit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi prokurorët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese.

Aktet administrative me efekt të përgjithshëm detyrues i nënshtrohen kontrollit të Gjykatës

⁴ Njoftimi dhe botimi i akteve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

⁵ Ankimi i vendimeve të Këshillit

Kushtetuese, në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, dhe kontrollit të Gjykatës Administrative të Apelit, në lidhje me pajtueshmërinë e tyre me ligjin”.

Në dispozitivin e vendimit objekt ankimi pranë KMD-së, Vendimit nr. 81, datë 31.03.2021 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në një nga pikat e tij, cilësohet se: *“Kundër këtij Vendimi lejohet ankimi sipas ligjit, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar”*, të drejtë të cilën ankuesi e ka ushtruar pranë KPA, nëpërmjet ankimit të tij me datë 19.04.2021, çështje e cila aktualisht është në fazën e gjykimit pranë këtij Kolegji.

Komisioneri, vëren se, kërkesa e z. M për të shqyrtuar e vlerësuar vendimmarrjen e KLP, lidhur me rastin e tij, nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për rrjedhojë, Komisioneri nuk mund të vlerësojë vendimmarrjen e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, sikurse është KLP. Për më tepër, vendimi i KLP, i është nënshtruar gjykimit të një hallke më të lartë hierarkisht, siç është KPA, e cila ushtron veprimtarinë e saj pranë GjK, dhe funksionon sipas përcaktimeve ligjore të posaçme⁶.

Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se: *“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës”.*

Në vendimin nr. 11, datë 27.05.2004, të Gjykatës Kushtetuese⁷, ndër të tjera, thuhet se: *“Në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, është përcaktuar se: “...vendimet gjyqësore mund të jenë objekt shqyrtimi vetëm mbi bazën e ankimeve ose rekurseve në rrugë gjyqësore, sipas përcaktimeve në kodet e procedurave ose në ligje të veçanta”. Pra, meqenëse ky pushtet ushtrohet në mënyrë të shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve gjyqësore të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta, asnjë organ tjetër, nuk ka të drejtë të kontrollojë e vlerësojë bazueshmërinë në ligj të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të mospërfillin përmbajtjen e tyre e të ngarkojnë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes. Duke iu referuar praktikës së saj, Gjykata Kushtetuese çmon të nevojshme për të rikonfirmuar qëndrimin se, vendimet gjyqësore kontrollohen vetëm nga gjykata më e lartë, e se, asnjë organ tjetër nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimeve gjyqësore, për sa kohë, ato nuk janë ndryshuar ose prishur nga një gjykatë më e lartë”.*

⁶ Neni 179/a, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligji 84/2016 *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

⁷ *“Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”*, e ndryshuar, në nenin 132, të saj, ka përcaktuar se: *“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim”.*

Neni 135, pika 1 e Kushtetutës, bën dallimin midis gjyqtarëve sipas funksioneve dhe në të njëjtën kohë kërkon t'i shkëpusë ata nga varësia hierarkike dhe ia nënshtrohen veprimtarinë e tyre në dhënien e drejtësisë, vetëm kontrollit të instancave më të larta gjyqësore, sipas rregullave të përcaktuara në kodet e procedurave.

Në nenin 145, të Kushtetutës, sanksionohet se, gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke nënkuptuar kështu, pavarësinë, përgjegjësinë dhe kompetencat e veçanta të gjyqtarit në dhënien e drejtësisë, nëpërmjet vendimmarrjes së çështjes konkrete. Asnjë pushtet apo organ tjetër nuk mund të veprojë si gjykatë dhe të marrë kompetencat e saj.

Pretendimet e ankuesit mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet kontrollit gjyqësor, ankimimit përpara gjykatave të shkallëve më të larta. Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit dhe për sa kohë nuk janë prishur apo ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjykatën që e ka shqyrtuar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim dhe kontrolli i vendimmarrjeve të KLP, apo faktit të mopërmbushjes së vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë prej Këshillit, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁸.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”*.

B. *Lidhur me kërkesën përsa i përket detyrimit të KLP, që të anonimizojë të dhënat e ankuesit në përputhje me detyrimin ligjor të parashikuar nga ligji i posaçëm, në të gjitha materialet e publikuara në faqen zyrtare të KLP, përfshirë vendimin nr. 81, datë 31.03.2021 dhe materialet audio të datës 16.03.2021, dhe të datës 01.04.2021, ku jepen publikisht të dhënat për ankuesin B. M.*

Bazuar në këtë kërkesë të ankuesit, Komisioneri vlerëson se shqyrtimi dhe vlerësimi i saj nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të ndryshuar, kjo

⁸ Për analogji citojmë Vendimin nr. 02, datë 11.01.2021, të KMD-së.

kompetencë i atribuohet institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Lidhur me sa më sipër, neni 29 dhe 30, i këtij Ligji kanë parashikuar se:

“Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale është autoriteti përgjegjës, që mbikëqyr dhe monitoron, në përputhje me ligjin, mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

“Komisioneri ka këto të drejta:

a) kryen hetim administrativ dhe ka të drejtën e aksesit në përpunimet e të dhënave personale, si dhe ka të drejtë të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave të mbikëqyrjes;

b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale;

c) jep udhëzime përpara se përpunimet të kryhen dhe siguron publikimin e tyre.

2. Komisioneri, në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Në kuptim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, “Anonimizim” është procesi i fshirjes së të dhënave personale në tekstin e vendimeve të publikuara, dhe çdo e dhënë personale në kuptim të nenit 3 të këtij ligji, kodohet me simbolin: {***}.

Neni 13⁹, i këtij Ligji, ka parashikuar se:

“1. Çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Kontrolluesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës së subjektit të të dhënave, duhet ta informojë atë për përpunimin e ligjshëm të të dhënave, kryerjen ose moskryerjen e korrigjimit apo të fshirjes.

3. Kur kontrolluesi nuk bën korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të kërkuara prej tij, subjekti i të dhënave ka të drejtë të ankohet te komisioneri”.

⁹ Neni 13 E drejta për të kërkuar korrigjimin ose fshirjen

Në këtë rast, bazuar në sa më sipër, kontrolluesi kryen vetë ose me kërkesë të subjektit të të dhënave korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji¹⁰.

E drejta e individëve që kanë subjekt i këtij Ligji, për t'u ankuar¹¹ është parashikuar në nenin 16 të tij, duke përcaktuar se:

“1. Çdo person, që pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm për të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për vënien në vend të së drejtës së shkelur. Pas këtij ankimi, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, subjekti i të dhënave mund të ankohet në gjykatë.

2. Në rast se subjekti i të dhënave ka bërë ankim, kontrolluesi nuk ka të drejtë të ndryshojë të dhënat personale deri në dhënien e vendimit përfundimtar”.

Kompensimi i dëmit për çdo person, të cilit i është shkaktuar një dëm, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, është parashikuar në nenin 17 të Ligjit, duke specifikuar se çdo person ka të drejtë t'i kërkojë kompensim kontrolluesit për dëmin e shkaktuar.

Në përfundim të sa më lart, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit për shkelje të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, të ndryshuar, lidhur me anonimizimin e të dhënave të tij në publikimet e bëra nga KLP, në faqen e zyrtare, mund t'i nënshtrohet vlerësimit nga ana e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi një shqyrtim i tillë, nuk bën pjesë në kompetencat lëndore dhe fushën e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për pasojë, ky kërkim i ankuesit nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e tij.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”*

C. Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim “për çdo shkak tjetër”.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh¹². Neni 1, i ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për

¹⁰ Neni 19 *“Detyrimi për korrigjim ose fshirje”*

¹¹ *“E drejta e ankimit”*

¹² Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh¹³.

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Referuar përmbajtjes së nenit 1 të LMD-së, rezulton tepër e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e përmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetvehte është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, subjekti ankues nuk ka identifikuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat personale të përcaktuara në LMD.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

¹³ Neni 14, I KEDNJ-së: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”.

Në bazë të nenit 7, të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument, indicie apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë shkakut specifik, duke mos arritur të identifikoj se cili është ky shkak.

Komisioneri vlerëson se, në bazë të rrethanave të shpjeguara dhe shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes. Ankuesi ka evidentuar e shpjeguar situatat dhe rastet kur ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë me prokurorët e tjerë (*referuar rasteve të publikimit të anonimizuar në faqen zyrtare të KLP-së, për 2 prokurorë, në ndryshim me sa ka ndodhur me ankuesin*), por nuk ka provuar shkakun për të cilin ai i është nënshtruar trajtimit të pabarabartë nga ana e Këshillit.

Përkundrazi, ankuesi vetëdeklaroi se: “*KLP e ka vënë atë në pozitë të pabarabartë në raport me subjekte të tjera që kanë qenë në pozitë të njëjtë duke theksuar se, ankuesi dhe subjektet e tjera të referuara prej tij, gëzojnë të njëjtën cilësi sikurse ai (magjistratë dhe prokurorë) dhe janë subjekte të procedimeve disiplinore po ashtu si ai*”, pra se nuk posedon cilësi apo karakteristika personale, të identifikueshme, mbi bazën e të cilave të kishte ardhur trajtimi i tij i pabarabartë krahasuar me prokurorët e tjerë, në kuptim të gëzimit e justifikimit të shkakut të mbrojtur sipas LMD-së.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se “*Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e ankuesit për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 12/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues B. M, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim
Shkaku: Çdo shkak tjetër
Lloji i vendimit: Mospranim